

KËRKESË
Nr. 522/11, datë 28.7.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall për disa shtesa në VKM-në nr. 332, datë 31.5.2023, “Për shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i aksit Thumanë–Vorë–Kashar’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Shoqëria “G2 Infra” sh.p.k.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “arë + truall”, sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa vlerësimi i pasurisë së llojit “ndërtesë” është llogaritur bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi ose jo banimi”, i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Shoqërinë “G2 Infra” sh.p.k., si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 244,420,138.85 (dyqind e dyzet e katër milionë e katërqind e njëzet mijë e njëqind e tridhjetë e tetë pikë tetëdhjetë e pesë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahim

LISTA PARAPRAKE PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 332, DATË 31.5.2023, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAITSHME, PRONË PRIVATE, OË PREKEN NGA PROJEKTI ‘NDËRTIMI I AKSIT RRUGORË ‘THUMANË-VORË-KASHAR’”

[illegible]

[illegible]